

VENDIM
Nr. 37, datë 18.1.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/20 KV GJIRI I LALËZIT, DURRËS**

(Ndryshuar me VKM nr. 528, datë 27.9.2017; nr. 386, datë 27.6.2018)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalëzit, Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.
3. *Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë totale të shpronësimit prej 1 296 602 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dy) lekë.*
4. *Vlera totale e shpronësimit, prej 1 296 602 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dy) lekë dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE, sh.a.), si subjekti kërkuar i këtij shpronësimi.*
- 4.1 *Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.*
5. *Shpronësimi të fillojë menjëherë.*
6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë, të pasurive të shpronësuar, në favor të OSHEE sh.a.
7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

(Ndryshuar me VKM nr. 528, datë 27.9.2017; nr. 386, datë 27.6.2018)

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 kV, GJIRI I LALËZIT”, DURRËS, FSHATË KURATEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Investitori: OSHEE sh.a.

Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

[illegible]